



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KRUIJË
Këshilli i Bashkiak

Nr. _____ Prot

Krujë më ____ / ____ /2018

VENDIM

Nr. 6 datë 02/02 2018

Për njësimin e pagës së funksioneve të transferuara me funksionet e Bashkisë.

Këshilli i bashkisë Krujë në mbledhjen e tij të datës 02/02 2018, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, aneksi 4, “për funksionet që financohen me transfertat specifike për vitin 2018, pika 5,6 dhe 7, paragrafi fundit, VKM Nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore” ndryshuar me VKM nr.177 datë 8.03.2017, nisur nga fakti se fondet e pagave për sektorin e pyjeve, bordin e kullimit dhe rruget rurale janë të pamjaftueshme dhe në udhëzim thuhet se: “Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor”, me qëllim njësimin e funksioneve të deleguara dhe të transferuara pranë bashkisë Krujë në përputhje me kategoritë dhe klasat në administratën e bashkisë Krujë për efekt page, pasi mori në shqyrtim propozimin e kryetarit të bashkisë, në përfundim,

VENDOSI:

1. Funkzioni “**Përgjegjës Sektor**”, në sektorin e Pyjeve dhe Sektorin e Bordit të Kullimit, njesohet me funksionin “Pergjegjes Sektor” ne bashkine Krujë dhe për efekt pagese grupohen në **klasën III.a/1**.
2. Funkzioni “**Specialist**”, në sektorin e Pyjeve dhe në Sektorin e Bordit të Kullimit njesohet me funksionin “Specialist” ne bashkinë Krujë dhe për efekt pagese grupohen në klasën III.b.
3. Funksionet e punonjësve administrative në këta sektorë njësohen me funksionet administrativ në bashki dhe për efekt pagese grupohen në klasën P.19.
4. Efektet financiare do të përballohen nga fondet e veta planifikuar për vitin 2018.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit për bazueshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Durrës.

KRYETARI I KËSHILLIT

HYSNI CACA

